



DITARI MUJOR

Tetor 2023



UE në Forumin e 6-të për Ndërkombëtarizimin e Arsimit të Lartë

Universiteti i Elbasanit "Aleksandër Xhuvani", merr pjesë në Forumin e 6-të për Ndërkombëtarizimin e Arsimit të Lartë me titull "Sigurimi i arsimit gjithëpërfshirës dhe cilësor, roli i ndërkombëtarizimit të arsimit të lartë për vendet në zhvillim" Forumi InterUni 2023 për ndërkombëtarizimin, organizuar në Universitetin WSB në Dabrowa Gornicza të Polonisë, është një ngjarje unike, që mbledh çdo vit ekspertë të huaj dhe vendas, të cilët trajtojnë problemet më të rëndësishme të ndërkombëtarizimit në arsimin e lartë, ku Universiteti i Elbasanit, u përfaqësua nga Zyra e Marrëdhënieve me Jashtë. Veprimtaria synon të zgjerojë njohuritë, të shkëmbejë përvoja në fushën e mbështetjes së studentëve të huaj dhe ndërtimit të kompetencave ndërkulturore, menaxhimi i aktiviteteve të shërbimit të studentëve të huaj; arsimimi në gjuhët e huaja, tejkalimi i problemeve të përshtatjes tek studentët e huaj, zgjerimi i integritit dhe ndërtimi i qëndrimeve gjithëpërfshirëse dhe tolerancës në kontekstin e universiteteve dhe mjedisit lokal. Në këtë takim, morën pjesë përfaqësues nga universitete të Afrikës, Azisë, Europës/US, etj, të cilët diskutuan mbi rolin, sfidat e ndërkombëtarizimit, strategjitë për rritjen e cilësisë së arsimit etj. Universiteti i Elbasanit prej vitesh ka në fokus të strategjisë institucionale ndërkombëtarizimin, i cili ka mundur, shkëmbimin kulturor dhe akademikë përmes programit Erasmus + dhe jo vetëm, rritjen e cilësisë së kërkimit shkencor studentor dhe akademikë, implementimin e projekteve në nivel kombëtarë dhe ndërkombëtarë, qasjen në bibliotekën më të madhe digjitale JSTOR, rritjen e konferencave kombëtare dhe ndërkombëtare e shumë të tjera.

Prezantim i Bursave Chevening



Në Universitetin e Elbasanit "Aleksandër Xhuvani", u zhvillua prezantimi i programit ndërkombëtar i bursave Chevening, ofruar nga Qeveria e Mbretërisë së Bashkuar. Studentët e UE-së u informuan nga përfaqësuesja e Programit Chevening mbi mundësitë dhe avantazhet që ofron ky program, si edhe kriteret e mënyrën për të aplikuar.

Workshop me studentët e UE-së



Në Universitetin e Elbasanit "Aleksandër Xhuvani", u zhvillua workshopi me temë "Procesi i integritit europian në Shqipëri - mundësitë për përfshirje të shoqërisë civile në procesin e negociatave për arsimin, shkencën dhe rininë"

Aktiviteti pati si fokus kryesor mundësitë për përfshirje të shoqërisë civile, studentëve, personelit akademik, që mbulojnë fusha të demokracisë, rinisë, arsimit dhe kërkimit shkencor, apo edhe bashkëpunimit rajonal sa i përket procesit të negociatave dhe informimit e konsultimit mbi kapitujt 25 (Shkenca dhe Kërkimi Shkencor) dhe 26 (Arsimi dhe Kultura) të Acquis së BE.



DITARI MUJOR

Tetor 2023

Takim në Fakultetin e Shkencave Mjekësore Teknike në kuadër të Tetorit Rozë

Në kuadër të aktiviteteve të ndërmarra gjatë muajit tetor, nën moton #TetoriRozë i shndërruar tashmë në një muaj vetëdijësi mbi Kancerin e Gjirit dhe rritjen e ndërgjegjësimit për shtimin e masave për zbulimin e hershëm të tij, Universiteti i Elbasanit në bashkëpunim me Institutin Parlamentar, përmes Shërbimit të Edukimit Qytetar, zhvilloi në ambientet e Fakultetit të Shkencave Mjekësore Teknike një aktivitet me pjesëmarrjen e studentëve, personelit akademik si edhe të deputeteve të Kuvendit të Shqipërisë Znj. Desantila Tahiraj dhe Znj. Zheni Gjergji. Në kumtesat e tyre, zëvendësrektorja e universitetit Prof.as.dr. Elvira Fetahu, Znj.Tahiraj dhe Znj. Gjergji, diskutuan me të pranishmit një spektër të gjerë tematikash, duke u ndalur edhe në mesazhe sensibilizuese vetëdijësi si individë dhe si shoqëri.



Ditët e informimit në Universitetin e Elbasanit për programin Erasmus +



Zyra e Marrëdhënieve me Jashtë në Universitetin e Elbasanit përfundoi me sukses "Ditët e Informimit", duke ofruar informacione për mundësitë e mobiliteteve të studentëve në kuadër të programit Erasmus+. Përgjatë këtyre ditëve, studentët e fakulteteve të universitetit, u informuan mbi avantazhet dhe përfitimet e të studiuarit në vende të ndryshme të Evropës e më gjerë. Ato u njohën me procedurat e aplikimit, kriteret dhe kërkesat për të qenë pjesë e programit Erasmus+. Universiteti i Elbasanit "Aleksandër Xhuvani", prej vitesh përmes programit Erasmus+, u ofron studentëve mundësinë për të studiuar në universitetet partnere, për të përfituar nga pervoja akademike dhe ndërkulturore si edhe për t'u zhvilluar në nivel personal dhe profesional.

Programit të Nxitjes së Punësimit për vitin akademik 2023-2024 në UE

Universiteti i Elbasanit "Aleksandër Xhuvani" në bashkëpunim me Drejtorinë Rajonale e AKPA-së, Elbasan ka mirëpritur ditën e sotme të rinjtë përfitues të Programit të Nxitjes së Punësimit për vitin akademik 2023-2024. Në këtë takim prezantues, Zëvendësrektorja e Universitetit të Elbasanit Prof.as.dr Elvira Fetahu dhe Drejtoresha Rajonale e AKPA-së Elbasan, Znj. Marsida Hyseni, informuan studentët mbi mundësitë dhe përfitimet e të ndjekurit të praktikave profesionale në një institucion të arsimit të lartë, siç është Universiteti i Elbasanit.



UE merr pjesë në workshopin organizuar nga TAIEX dhe Bashkia Elbasan



Universiteti i Elbasanit "Aleksandër Xhuvani", mori pjesë në Workshop-in me temë "Transformimi i Neutralitetit Klimatik në Ballkanin Perëndimor", organizuar nga TAIEX dhe Bashkia Elbasan, me pjesëmarrjen e ekspertëve të ndryshëm nga Bashkimi Europian." Në këtë workshop Universiteti i Elbasanit, ishte pjesë e panelit "Perspektivat e veprimit për klimën urbane: njohuri nga studiues dhe praktikues. Ky workshop shërben për të mbështetur shkëmbimin e zgjidhjeve të zbatimit, qeverisjes dhe financimit për të arritur neutralitetin klimatik të qyteteve.